

FJALA E DEPUTETIT LAVDRIM KRRASHI E HËNË 23 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të dashur kolegë deputetë dhe qytetarë,

Mandati ynë si përfaqësues të vullnetit demokratik të zgjedhësve na detyron që në çdo vendim tonin të kemi përparësi absolute interesin tonë kombëtar, natyrshëm edhe vullnetin e zgjedhësve tanë. Kam pasur nderin dhe kënaqësinë ta vizitoj Dibrën fshat më fshat dhe qytet më qytet çdo javë, prej muajsh tashmë që nga shtatori edhe si përfaqësues i tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Dibra është ndër qarqet e zhvillimit më të ngadaltë në këta 30 vjetët e fundit. Takimet e vazhdueshme me banorët më kanë lënë të kuptoj se sfidat mbeten të shumta, por jam i lumtur të them se projektet e viteve të fundit dhe vëmendja e rikthyer ndaj zonës kanë rikthyer shpresën edhe një herë se gjërat po ndryshojnë. Shumë prej tyre, ashtu si edhe unë, mbeten krenarë dhe optimistë që janë bij të një zone me tradita dhe histori të ndritur, njerëz punëtorë e me bukuri të rralla natyrore. Potenciali i këtij qarku është tepër i lartë dhe sot dua të ndaj me ju punën e nisur prej muajsh tashmë, si dhe ambiciet tona për Dibrën që ne e duam të gjithë. Sigurisht, vëmendja kryesore e deritanishme ka qenë te përfundimi i Rrugës së Arbrit, një investim madhor prej qindra milionë eurosh, por me një vlerë jetësore të pallogaritshme jo vetëm për banorët e zonës, por për të gjithë dibranët dhe shqiptarët. Ajo do të jetë një urë lidhëse jo vetëm për ata që jetojnë aty apo e vizitojnë shpesh, të cilët do të mund t'u gjenden më pranë të afërmeve të tyre, por do t'u japë një shtysë më të fortë bizneseve të krejt zonës. Unë dua të falënderoj veçanërisht taksapaguesin shqiptar dhe vendosmërinë e qeverisë për këtë projekt kaq frymëzues, që do t'u shërbejë brezave në vazhdim, do të na sjellë të gjithë më pranë njëri-tjetrit dhe t'i ofrojë të gjithë administratës përgjegjëse mbështetjen maksimale për një përfundim sa më të shpejtë e të suksesshëm. Përfundimi i këtij projekti, i cili është në vazhdimësi në vëmendjen dhe në përparësitë tona, lidhet ngushtë me shumë projekte të tjera për rigjallërimin e zonës. Në radhë të parë, është turizmi. Dibra ofron peizazhe marramendëse për ata që e duan natyrën dhe ajrin e pastër. Mjafton të mendojmë për liqenet e Lurës apo për Korabin madhështor. Të gjithë ata, që duan t'i shohin më nga afër këto pamje, do të kenë tashmë mundësi ta bëjnë këtë për 2 orë me automjetet e tyre. Ne presim që ky zhvillim i turizmit të shoqërohet shumë shpejt edhe me lindjen e numrit të bizneseve në mbështetje të turizmit dhe të vizitorëve, si agroturizmi, që ka bërë hapa të rëndësishëm kohët e fundit. Ne shpresojmë që rritja e kërkesës t'i mbështesë më tej këto sipërmarrje interesante. Me rritjen e industrisë së shërbimeve dhe të mikpritjes dibrane, ne duam që edhe fermerët të kenë një treg më të fortë, ku prodhimet e tyre të jenë pjesë e tërheqjes së vizitorëve për të shijuar prodhime të cilësisë së lartë të zonës, që Dibrës nuk i mungojnë. Kam marrë pjesë në evenimente, si panairë të produkteve, ku shpaloset tradita dhjetërvjeçare nga artizanët, blegtorët dhe fermerët dibranë, të cilët, po të kenë më shumë mbështetje në lidhje me zinxhirin e sipërmarrjes, mund t'i rrisin kapacitetet e tyre dhe t'u ofrohen konsumatorëve në rang shumë më të gjerë, si dhe prodhimet e tyre të shiten në të gjithë Shqipërinë, por edhe në vendet fqinje. Këto takime janë të domosdoshme për të shpalosur pasuritë e Dibrës dhe ato do të vazhdojnë të kenë mbështetje për të rritur më tej ndërgjegjësimin dhe promovimin e prodhimeve dibrane për të zgjeruar tregun dhe klientelën përtej kufijve të qarkut tonë. Anë tjetër e turizmit janë, për

shembull, ujërat termale ose llixhat, pelegrinazhi në zonat historike të Kastriotëve, kampingu e të tjerë. Janë vetëm një numër shumë i vogël i shërbimeve të shumta që Dibra mund të ofrojë, po të ketë mbështetjen dhe organizimin e duhur, për të cilin ne jemi të fokusuar për ta përmirësuar në katër vjetët e ardhshëm. Por ne duam të investojmë edhe në burime njerëzore. Një shembull shumë i mirë për këtë është spitali i Peshkopisë, i cili i ka të gjitha premisat për t'u kthyer në një qendër të madhe shëndetësore rajonale në sajë të infrastrukturës dhe të pajisjeve që ofron. (Bie gongu.) Për këtë arsye është e rëndësishme t'i mbështesim studentët dhe profesionistët që duan t'i rikthehen Dibrës për të kontribuar për të. Kjo bëhet jo vetëm nëpërmjet edukimit dhe trajnimit të brezave të rinj, po edhe të kuadrove ekzistues, shumë prej të cilëve, për fat të keq, i janë larguar Dibrës. Unë, personalisht, kam nisur diskutime të ndryshme jo vetëm me zyrtarë dhe biznese vendase, por edhe duke bashkorganizuar konferenca edhe jashtë vendit, si në Londër këtë nëntor, ku do të diskutohet për mbështetjen që duhet të ketë, që diaspora jonë mund të japë në lidhje me këtë sektor të suksesshëm. Ju falënderoj!